



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:166942

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05577944

KPPP.nr. 1178/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Arjeta Group”, me numër unik identifikues 811014282 dhe me seli në Skënderaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.S., avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Viva Fresh Store”, me numër unik identifikues 810670390 dhe me seli në Prishtinë, Suhadoll, Magjistratja Prishtinë – Lipjan, p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 135/2022 i datës 20.04.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak S. Shumolli nga Ferizaj, jashtë seancës me datën 16.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Viva Fresh Store”, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 135/2022 i datës 20.04.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak S. Shumolli, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Arjeta Group”, me datë 20.04.2022 ka lëshuar urdhrin P.nr. 135/2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 20-2/85231, e datës 23.12.2021 dhe Faturës nr. 20-2/84222, e datës 09.12.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 25,000.31 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 09.12.2021, si datë e arritshmërisë për pagesë e deri pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbarimor me arsyetim se borxhin sipas faturave e ka paguar në tërësi duke lëshuar “pagesa grupore”. Ka shtuar se kanë pasur marrëveshje me kreditorin për një kohë të caktuar dhe se gjatë kësaj periudhe janë përmbushur të gjitha obligimet – borxhet e pretenduara nga kreditori. Më tej, ka theksuar se kontrata nr. 259, e datës 20.04.2021 e lidhur mes kreditorit dhe debitorit ka qenë me afat validiteti deri me datë 31.12.2021 ku përmes njoftimit të datës 01.12.2021 kreditori ka njoftuar se nuk mund të vazhdojnë bashkëpunimin me kushtet e njëjta. Duke qenë se përkundër njoftimit të kreditorit nuk kanë arritur ndonjë marrëveshje tjetër me shkrim, debitori ka vazhduar të bëjë ekzekutimin e pagesave, ndërsa kreditori nuk ka vazhduar me furnizim në bazë të kontratës, e cila nënkupton shkëputjen e parakohshme të kontratës. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumentit i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 20-2/85231, e datës 23.12.2021 dhe Fatura nr. 20-2/84222, e datës 09.12.2021, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit pasi që janë të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se borxhi sipas faturave është përmbushur në tërësi, e po ashtu i vlerësoi provat e bashkangjitura nga debitori si në prapësim, por gjeti se të njëjtat nuk provojnë ekzistimin e asnjë prej shkaqeve të parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1178/23, datë 16.04.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.